VENDIM
Nr. 123, datë 9.11.2016

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHTESË NGA BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "e", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit"; nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të nenit 18, pika 8, të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, e ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka Societe Generale Albania sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, duke vepruar si agjent në sigurime.
2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Societe Generale Albania sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko